



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 969/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Avokat L.V. me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson M.B., avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur sipas propozimit të debitorit të paraqitur ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 280/23, i lejuar me datë 15.05.2023, nga Përbaruesi Privat Blerim Baloku me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 09.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar propësimi i debitorit Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 280/23, i lejuar me datë 15.05.2023, nga Përbaruesi Privat Blerim Baloku, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Avokat L.V., mbi bazën e dokumentit përbarimor, Marrëveshjes për ndërmjetësimin me numër 24/2022, e datës 27.12.2022, ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 280/23, të datës 15.05.2023, ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës për pagimin e shumës prej EUR 312.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përbarimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përbarim në lartësi prej EUR 117.00.

Debitori, në propësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përbarimit dhe ka shtuar se marrëveshja mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk përbën dokument përbarimor ngase e njëjta ka parregullsi. Me tej, ka theksuar se kreditori nuk i është drejtuar debitorit me kërkesë zyrtare apo me ndonjë faturë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që propësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, në përgjigje në prapsim ka theksuar se debitori nuk ka paraqitur asnjë shkak mbi bazën e së cilit mund të anulohet urdhri përbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa ka shtuar se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri

përmbardimor përbën dokument përmbardimor, i cili përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë dhe se i njëjti ka fuqinë e dokumentit përmbardimor në përputhje me dispozitat e LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa i ka kërkuar edhe shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në lartësi prej EUR 234.00.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbardimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së, “*Organi përmbardues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbardimin vetëm në bazë të dokumentit përmbardues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të Ligjit për procedurën përmbardimor, lidhur me nenin 5.1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi procedurën përmbardimore, është përcaktuar si dokument përmbardimor edhe marrëveshja e lidhur në procedurë të ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin.

Gjykata në rastin konkret ka shqyrtuar dokumentin përmbardimor Marrëveshje e ndërmjetësimit nr. 024/2022 e datës 27.12.2022 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbardimi, dhe gjeti se palë kontraktuese, përkatësisht kreditor në këtë marrëveshje paraqiten personat fizik G.Sh, J.M., N.P., I.Z. dhe B.M., të përfaqësuar nga avokat L.V. si dhe Komuna e Fushë Kosovës në anën tjetër në cilësi të debitorit.

Në këtë drejtim, Gjykata gjen se kreditori i listuar në propozimin për përmbardim avokat L.V., nuk është palë në marrëveshjen e ndërmjetësimit mirëpo që i njëjti ka vepruar në cilësi të të autorizuarit të palëve, ashtu që i njëjti nuk është person i autorizuar që të kërkoj realizimin e detyrimit monetar prej EUR 312.00 ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, ngase nuk është titullar të se drejtës së përcaktuar në dokument përmbardimor, përderisa kërkesa monetare i është njohur palëve pjesëmarrëse në procedurën e ndërmjetësimit si shpenzim për përpilimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar.

Prandaj, duke qenë se ekzekutimi i dokumentit përmbardimor mund të lejohet vetëm në dobi të personit i cili sipas dokumentit përmbardimor është i autorizuar të kërkoj përmbushjen nga debitorit i përcaktuar në dokument përmbardimor, në rastin konkret vetëm në dobi të palëve në marrëveshje dhe jo kreditorit si në propozim për përmbardim, gjykata vlerëson se prapësimi i

debitorit gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “*prapësimi mund të bazohen vetëm nëse*”, ndër të tjera, “*kreditore nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit*”. Rrjedhimisht, edhe urdhri përmbartimor duhet të anulohet për ngase kreditore në propozim për përmbartim nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin përmbartimor mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 969/23, datë 09.01.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.